



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E DOGANAVE

---

**RAPORT  
PËR PUNËN E DREJTORISË DOGANORE NË TETOR 2009**

**NËNTOR 2009**

---

## **I. Përforcimi i kapacitetit institucional**

1. Në pajtim me Ligjin për ratifikim të Protokollit për përfshirjen e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore Tregtare (në raport të të dhënave doganore) dhe Nomenklatura e kombinuar e UE për 2010 ( Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 948/2009 të shpallur në Gazetën zyrtare të UE nr. 287 nga 31.10.2009) është përgatitur tarifa doganore e Republikës së Maqedonisë për vitin 2010.

Në suaza të tarifës doganore për 2010 janë zbritur MFN përqindjet doganore të 426 paragrafa tarifore si rezultat i trendeve më të reja në tregti, ndërsa për shkak uljes së vëllimit të tregtisë të disa mallrave të caktuar janë fshirë gjithsejtë 330 shenja tarifore, ndërsa janë futur 167 shenja të reja tarifore dhe 31 shenja tarifore të reja në nivel nacional.

Në përgjithësi, tarifa doganore për 2010 me ndryshimet në shenjat tarifore dhe emërimet e mallrave përfaqësojnë në përgjithësi është harmonizuar me nomenklaturën e kombinuar të UE për 2010, përveç shenjave të reja nacionale tarifore të cilat dallohen në shifrën e nëntë dhe të dhjetë, ndërsa të cilat janë futur për shkak se grupimi i mallrave në një shenjë tarifore nuk është e mundur për atë se janë me përqindje doganore të ndryshme.

Ndryshimet e tarifës doganore për 2010 në raport të zbritjes së përqindjeve doganore, në pajtim me Ligjin për ratifikimin e Protokollit për përfshirjen e Republikës së Maqedonisë në Organizatën Botërore Tregtare do të sfidon implikacione fiskale. Zbritje më të madhe të përqindjeve doganore ka në Seksionin XI, për tekstil dhe prodhime tekstili, të Kapitullit 61, 62 dhe 63 ku përqindja doganore zvogëlohet për 30%.

Në pajtim me të dhënat statistikore të disponueshme, të dhënat doganore të paguara për prodhimet e importuara tekstili nga kapitujt e theksuara në 2008 arrin 401 milion denar (rreth 6,6 milion euro), ndërsa në 2009 arrin 277 milion denarë (rreth 4,5 milion euro). Me uljen e përqindjeve doganore për 30% në 2010, të dhënat e paguara do të zvogëlohen për 83 milion denarë në krahasim me vitin e mëparshëm.

Megjithatë, duhet të theksohet se zbritja e përqindjeve doganore, gjithashtu mund të ndikojë në mënyrë stimuluese për rritjen e vëllimit të importit të këtyre prodhimeve, me çka implikacionet fiskale do të zvogëlohen.

2. Në tetor 2009 Drejtoria doganore ka mbledhur gjithsejtë 3.221 milion denarë (52,8 milion denar) në emër të të ardhurave buxhetore, e cila është 28 % është më pak në krahasim me periudhën e njëjtë 2008.

Nga gjithsejtë të ardhurave buxhetore të paguara sipas llojit, në emër të doganës dhe të dhënave tjera doganore në tetor 2009 janë mbledhur 419 milion denarë (rreth 6,9 milion euro) ku për 27% është më pak në krahasim me periudhën e njëjtë 2008.

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në tetor 2009 arrin 2.699 milion denarë (rreth 44,2 milion euro), ku është për 29% më pak në krahasim me periudhën e njëjtë 2008.

Të ardhurat e mbledhura nga akcizat arrin 80 milion denarë (1,3 milion euro) ku për 11% është më pak në krahasim me periudhën e njëjtë 2008.

Të ardhurat e mbledhura nga kompensimet arrin 24 milion denarë (393 mijë euro) të cilat në raport me tetorin e 2008 janë për 44% më shumë të ardhura nga kompensimet.

Në periudhën janar-tetor 2009 Drejtoria Doganore ka mbledhur 31.878 milion denarë ( rreth 523 milion euro) në emër të të ardhurave buxhetore, e cila është për 26% më pak krahasuar me të njëjtën periudh të vitit 2008.

Nga pagesa totale e të ardhurave buxhetore sipas llojit, në emër të doganës dhe të dhënave tjera doganore në periudhën janar-tetor janë mbledhur 4.408 milion denarë (rreth 72,3 milion euro) ku është për 17% më pak në krahasim me 2008.

Një nga arsyejet për uljen e të dhënave doganore është vëllimi i importit të zvogëluar e cila ka të bëjë me krizën ekonomike globale botërore, e cila reflektoi edhe në ekonominë tonë. Ulje të vëllimit të importit sipas vlerës statistike e cila përfshinë edhe të dhëna të zvogëluara doganore ka të bëjë gjithashtu me vlerat e zvogëluara të mallit të importuar veçanarisht të prodhimeve bursë. Ulje të rëndësishme të vëllimit të importit sipas vlerës në vitin 2009 në raport me vitin 2008 ka tek mishi dhe prodhimet nga mishi, peshq, kafe, çaj, drithëra, vaj për ushqim, kakao dhe prodhime nga kakao, produkte të ndryshme për ushqim, karburantet minerale, plehrave, tavolina plastike dhe prodhime nga ato, lëkurë të papërpunuar, letër dhe prodhim nga letrat, veshmbathje, këpucë, metale dhe prodhime nga ato, prodhime nga kapitulli 84 dhe 85, mobilie, të cilat paraqesin pjesë të rëndësishme nga vëllimin i importit. Zbritja e vlerës së këtyre prodhimeve bëhet për shkak çmimeve të ulta të këtyre prodhimeve të cilat prodhohen në bursa botërore. Gjendja reale dhe objektive e çmimeve botërore kanë ndikuar në vlerën e reprometereve dhe të prodhimeve të gatshme. Ndikim ka edhe ulja e përqindjes doganore dhe përqindjet preferenciale doganore por ajo është më pak në raport me vlerën e paraqitur të mallit.

Ndaj mbledhjes së përgjithshme të të dhënave doganore nuk ndikojnë lirimet e një lloji të caktuar të mallrave nga mbledhja e të dhënave doganore, për arsye se vëllimi i importit sipas vlerës me lirim në tetor 2008 ka arritur 83,9 milion denar ndërsa në tetor 2009 ka arritur 92,7 milion denarë, por të dhënat doganore të cilat është dashur të paguhen gjegjësisht kanë qenë lëndë të liritimit në tetor 2008 ka qenë 7 milion denarë, ndërsa në tetor 2009 ka qenë 6,7 milion denar.

Të ardhurat e mbledhura nga TVSH në periudhën janar-tetor 2009 arrin 26.498 milion denarë (rreth 434,4 milion euro) e cila është për 28% më pak në krahasim me periudhën e njëjtë 2008.

Të ardhurat e mbledhura nga akcizat, në periudhën janar-tetor 2009 arrin 740 milion denarë (rreth 12,1 milion euro) e cila është për 5%% më pak në krahasim me periudhën 2008.

Të ardhurat e mbledhura nga kompensimet në periudhën janar-tetor 2009 arrin 231 milion denar (rreth 3,8 milion euro) e cila është për 4% më shumë nga kompensimet e realizuara në periudhën e njëjtë 2008.

## II. Kapaciteti administrativ

3. Në tetor 2009 janë realizuar 36 trajnime në forma të ndryshme në të cilën kanë marrë pjesë 626 nëpunës doganor, në kohëzgjatje prej 334 orë. Kohëzgjatja mesatare e trajnimeve për të punësuarit të cilët kanë ndjekur trajnimet është 8,61 orë. Numri i aktiviteteve të realizuara në periudhën nga janari deri në tetor 2009 është 199 ngjarje në të cilën kanë marrë pjesë 2.671 pjesëmarrës, me numër mesatar të orëve të trajnimeve për çdo pjesëmarrës 65,14 orë, përkatësisht 8,14 ditë pune.

Gjatë këtij muaji janë mbajtur trajnimet, seminarët, prezantimet dhe kurset në vijim:

- Simpoziume ndërkombëtare me temë “zbatimi i mbrojtjes së të drejtave nga pronësia intelektuale”;
- 7 prezantime për zbatimin e Udhëzimit për punë me informatorët, Udhëzimi me listë qendrore të akuzuarve dhe Udhëzim për punë të Repartit për kundërzbulim;
- 10 trajnime për përdoruesit kyç të aplikimit për sistemin e menaxhimit elektronik me dokumente – eDMS;
- Trajnim për zbatimin e Udhëzimit për zbatimin e procedurës doganore gjatë importit të përkohëshëm të mallrave për turizmin e gjuetisë dhe Udhëzimi për mënyrën dhe procedurën e arrestimit, mbajtjes dhe marrjes në pyetje të personit fizik;
- Trajnim me temë “lejet CEMT, leje të ndara transporti, Konventa CMR dhe Ligji për qarkullimin rrugor”;
- Punëtori për zbatimin e masës konfiskacija;

Në suaza të programit për trajnime themelore për nëpunësit doganor të ri janë mbajtur trajnimet në vijim:

- trajnim për tarifa doganore;
- trajnim për dispozitat ligjore të cilat zbatohen në procedurën tranzite, tarifën doganore, vlerën dhe prejardhjen e mallit;
- trajnim për punë me MAKCIS, kontrolle të automobilave, mallrave dhe udhëtarëve dhe identifikimin e drogave;
- trajnim nga fusha “Oracle database 10g: Program with PL/SQL”;
- 5 trajnime për menaxhimin me akciza;
- trajnim për trajnuesit;
- trajnim për DVD, procedurë tranzite, TIR dhe ATA karnete;

Me përfaqësues të vetë Drejtoria doganore ka marrë pjesë aktive në aktivitete ndërkombëtare në vijim:

- Mbledhja e 5 të grupës punuese për siguri të dërgesave me kontejner në Athinë, Greqi;
- Konferenca në suaza të projektit RACWEB në Bruksel, Belgjikë;
- Mbledhja e 4 plenare të Komisionit Evropian për kontroll të transportit ndërkufitar të parave në kuadër të Programit CUSTOMS 2013, La Vileta, Maltë;
- Konferenca me temë Zhvillim dhe lehtësim të tregtisë të ekonomive në tranzicion në Gjenevë, Zvicër;
- mbledhja e 14 vjetore RILO/NCP për Evropën Jugore dhe Qendrore, në Talin Estoni
- Nën organizim të DG TAXUD, në La Valeta Malta, është mbajtur seminar për menaxhim të pjesshëm dhe TI të administratës doganore dhe tatimore;
- Punëtori regionale ndërmjet Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë dhe Zyrës për ozon e cila është mbajtur në Budapesht.

### **III. Integriteti dhe lufta kundër korrupsionit**

4. Në tetor 2009 janë realizuar 10 hetime të brendshme në njësitë organizative të Drejtorisë doganore.

Pas përfundimit të hetimeve është përgatitur 1 raport me përfundime për dyshimet e arsyeshme se nëpunësit doganor kanë punuar në kundërshtim me dispozitat pozitive ligjore, aktet nënligjore, udhëzimet operative dhe kodit etik përkatësisht ka vepruar në kundërshtim me dispozitat nga Udhëzimi për kontrakta preferenciale.

Në 9 raporte nuk është konstatuar punë të doganierëve e cila është në kundërshtim me dispozitat ligjore, aktet nënligjore, instruksionet operative dhe kodit etik.

Gjatë tetorit janë bërë ekspertiza plotësuese me Entin për ekspertizë gjyqësore në lidhje me ngritjen e kallëzimeve penale kundër nëpunësve doganor të cilat janë në fazë të ekspertizave gjyqësore.

Në muajin e njëjtë janë realizuar pesë procedura disiplinore kundër pesë nëpunësve doganor ku janë shqiptuar :1 masë ndërprerje të marrëdhënies së punës, 2 dënime me para ndërsa 2 procedura disiplinore janë ndërprerë.

5. Nga gjithsejtë 24 masa disiplinore të shqiptuara ndërprerje të marrëdhënies së punës në 2009, 12 akoma nuk janë të plotfuqishme sepse vendimet e Drejtorisë Doganore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë dërguar në ankesë deri te Komisioni i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vendosje sipas ankesave nga marrëdhëniet e punës. Ky komision akoma nuk ka marrë vendim sipas ankesave (duke filluar nga qershori 2009 e këndej), ndërsa personat të cilëve iu është shqiptuar masa disiplinore ndërrprerje të marrëdhënie së punës akoma punojnë në Drejtorinë Doganore.
6. Në fund të tetorit 2009, kundër Drejtorisë Doganore kanë qenë aktive 109 lëndë gjyqësore në bazë të kontesteve nga marrëdhënia e punës. Nga këto, 46 lëndë gjenden në gjykatat themelore, nga të cilat 42 lëndë në procedurë të shkallës së parë me afat prej 1 deri më 24 muaj dhe 4 lëndë në procedurë të përsëritur me afat prej 1 deri më 7 muaj. Në procedurë tek gjykatat e apelit gjenden 37 lëndë me afat prej 1 deri më 12 muaj. Në procedurë tek gjykata supreme gjenden 18 lëndë me afat prej 1 deri më 36 muaj.
7. Në tetor është kryer një auditim i brendshëm ku janë konstatuar 6 mendime për të cilat janë dhënë 6 rekomandime për veprim dhe të njëjtat janë pranuar nga subjekti i reviduar.

### **IV. Transparenca**

8. Në tetor 2009 nëpërmjet linjës së hapur telefonike (nr 197) janë pranuar gjithsejtë 3.722 thirrje. Për shkak koordinimit dhe veprimit më të lehtë me informatat të njëjtat klasifikohen dhe me të veprohet në mënyrën në vijim:
  - A klasë (3 thirrje janë pranuar) - informata për të cilët veprohet menjëherë dhe të njëjtat dorëzohen deri tek Reparti për punë operative ose njësi doganore.
  - B klasë (janë pranuar 4 thirrje) - informata të cilat është e nevojshme përpunim plotësues dhe të njëjtat dorëzohen deri te repartet kompetente (kundërzbulim, hetim, kontroll të shoqeatave tregtare, analizë të rrezikut).

- J klasë (janë pranuar 7 thirrje)- informata për sjelljen joprofesionale të nëpunësve doganor të cilat dorëzohen te Sektori për përgjegjësi profesionale.

Në tetor 2009 në faqen oficiale të internetit janë shpallur 91 informata në gjuhën Maqedonase, Angleze dhe Shqipe, ndërsa në intranet portalin janë shpallur informata për të punësuarit në Drejtorinë doganore ku janë shpallur 25 informacione.

#### **V. Ndalimi i importit,eksportit dhe transitit të mallit jolegal dhe mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale**

9. Në bazë të informatave të zbuluara dhe analizave të rrezikut, njësitë speciale mobile të Drejtorisë doganore në tetor 2009 kanë kryer kontroll në 378 kamiona, 269 autobusa, 174 automobila të pasagjerëve, ose gjithsejtë 821 automjete në vendkalimet kufitare dhe në brendësinë, ndërsa shërbimi për skener ka kryer 2065 skenime në 1.674 kamiona, 160 autobusëve dhe 231 automobila të pasagjerëve, me ç'rast janë konfiskuar mallra të ndryshëm. Njëkohësisht edhe nëpunësit doganor në vendkalimet kufitare dhe në njësitë e brendshme doganore kanë ndaluar shumë tentime për kontrabandë ku kanë konfiskuar mbi 78 mijë copë mallra tregtar ose mbi 100 lloje mallra tregtar: 53,8 mijë copë cigare, 10,5 copë vazna, 4,3 mijë fidane dhe mallra të ndryshëm për amvisëri dhe industri. Në bashkëpunim me MPB janë konfiskuar 27 kg drogë- heroinë. Në pikat kufitare janë konfiskuar deviza në shumë prej 146 mijë franga Zvicrane dhe 25,8 mijë euro.

Në vendkalimin kufitar Bogorodicë Drejtoria doganore ka ndaluar tentim për kontrabandën e katër personave emigrant nga Avganistani pa dokumente për identifikim. Pas zbatimit të procedurës së parahetuesis dhe marrjes në pyetje, personat janë vendosur në qendrën private për të huaj, ndërsa kamioni bashk me mallin përkohësisht është konfiskuar. Kundër ngasësit të kamionit është ngritur kallëzim penal për shkak ekzistimit të dyshimit për bërjen e veprës penale “Kontrabandë të emigrantëve”. Gjithashtu, më 19.10.2009 është ndaluar dhe një tentim tjetër për kontrabandimin e një personi nga Republika e Serbisë nga ana e një ngasësi shtetas i Serbisë në pikën kufitare Tabanoc. Pas përfundimit të procedurës së hetuesis, është ngritur kallëzim penal për brëjen e veprës penale.

10. Për tentimet e zbuluara për transport të mallrave të palejuar si dhe për veprimet tjera të palejuara deri tek komisioni për vendosje sipas kundërvajtjes pranë Drejtorisë doganore janë dorëzuar 107 kërkesa për sjelljen e procedurës kundërvajtës, nga të cilat 16 kërkesa sipas kallëzimeve kundërvajtës për vetura të dorëzuara nga MPB, 14 kërkesa sipas procesverbaleve për kundërvajtje doganore të dorëzuara nga sektori për kontroll dhe hetim, 71 kërkesa sipas procesverbalit për kundërvajtje doganore të dorëzuar nga njësitë doganore, dhe 6 janë lëndë kthyese nga gjykatat themelore. Komisioni për vendosje sipas kundërvajtjes pranë Drejtorisë doganore në tetor 2009 ka zgjidhur 53 lëndë në procedurë të rregullt dhe urgjente dhe për të njëjtët ka shqiptuar gjobë në shumë prej 4,18 milion denarë (rreth 76,4 mijë euro).
11. Në shtator 2009 Drejtoria Doganore ka lëshuar 199 thirrje për pagimin e gjobave, përkatësisht janë shqiptuar dënime mandate për autorët e kundërvajtjeve doganore në shumë të përgjithshme prej rreth 1,3 milion denarë (rreth 20,8 mijë euro).
12. Në këtë muaj Drejtoria doganore deri tek Prokuroritë publike ka parashtruar 12 kallëzime për ngritjen e procedurës penale kundër 13 personave fizik dhe 4 kundër personave juridik. Arsyet për parashtrimin e kallëzimeve penale në tetor 2009 janë në vijim:
  - kontrabanda - 1 kallëzim penal kundër 1 personi fizik,

- kontrabandë të emigrantëve – 1 kallëzim penal kundër 1 personi fizik,
- prodhim dhe lëshimi në qarkullim i mjeteve për sërëm – 1 kallëzim penal kundër 1 personi fizik,
- qarkullim i mallrave akcize pa banderole – 4 kallëzime penale kundër 4 personave fizik,
- transporti me mallra akcize nga depo akcize në qarkullim të lirë – 1 kallëzim penal kundër 2 personave fizik,
- mashtrim doganor – 4 kallëzime penale kundër 4 personave fizik dhe 4 kundër personave juridik.

Vlera e përgjithshme e mallit lëndë e veprave penale arrin 2,4 milion denar (rreth 39 mijë euro), ndërsa të papaguara gjegjësisht të dhënat e ikura doganore arrin 5,8 milion denarë (rreth 95 mijë euro).

13. Në tetor 2009 Drejtoria Doganore ka intervenuar në 16 raste për tentim të shkeljes së të drejtave nga pronësia intelektuale dhe përkohësisht ka konfiskuar 5.635 mijë copë mall për shkak dyshimit të arsyeshëm se bëhet fjalë për falsifikat të markave tregtare.

Një pjesë e madhe të mallit të konfiskuar përbëhet prej;

- 1.304 palë atlete
- 900 goma traktori
- 2.092 prodhime tekstili
- 547 ora dore
- 333 palë çizme për fëmijë
- 300 maska për celularë
- 160 kuleta

Drejtoria doganore ka lëshuar 9 leje për ndërmarrjen e veprimeve për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale për markat tregtare: SOBRANI, SUPERGA, FIRESTONE, BEIERSDORF, ELASTOPLAST, EUCERIN, HANSAPLAST, LABELLO dhe ATRIX.

Në tetor 2009 Drejtoria doganore ka lëshuar vendime për asgjësimin e 22.012 copë mall lëndë e shkeljes së të drejtave nga pronësia intelektuale, edhe atë për mallrat tregtare në vijim: BOSS dhe JOOB, D&G, ADIDAS, CONVERSE, MAX FACTOR, LACOSTE, CALVIN KLEIN dhe KENZO. Janë asgjësuar 2.459 copë mallra të falsifikuara për mallrat tregtare në vijim: NIKE, D&G, CONVERSE, ADIDAS dhe PUMA.

## **VI. Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërkombëtar dhe projektet**

14. Në mbledhjen e rregullt të trupit këshidhënës të mbajtur më 01.10.2009 është nënshkruar Aneks të Memorandumit për bashkëpunim dhe miqësi dhe Aneks të Memorandumit për formimin e trupit këshidhënës me të cilën Oda Ekonomike Amerikane në Maqedoni është bërë anëtare e re e trupit këshidhënës. Në mbledhje kanë marrë pjesë përfaqësues nga Drejtoria Doganore, Oda ekonomike e RM, Lidhja e Odave Ekonomike në RM, Oda Ekonomike e Maqedonisë veri-perendimore, MAKAMTRANS, SIZ “Makedonija Sobraqaj” AMERIT dhe Oda Ekonomike Amerikane në Maqedoni.
15. Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Drejtoris Doganore të Republikës së Maqedonisë dhe Univerzitetit “Shën Kirili dhe Metodi” Fakulteti ekonomik nga Shkupi, OBD dhe

Sekretarijati CEFTA, më 15 dhe 16 tetor 2009 është mbajtur konferenca ndërkombëtare “Bashkëpunimi regjional dhe intergimi ekonomik- sfida dhe mundësi”.

Në kuadër të kongerencës dyditore është biseduar në tre forume kryesore: Marrëveshjet rajonale tregtare dhe bashkëpunimi rajonal, CEFTA -2006- bashkëpunimi tregtar dhe investimet e huaj direkte në Evropën Juglindore – disa aspekte sektoriale për përmirësimin e konkurrencës në rajon dhe në statistikën tregtare dhe njoftimet.

16. Më 26 tetor 2009 në vizitë të Drejtorisë doganore të RM ka qëndruar “Ekipi i vlerësimit dhe monitoringut”, në Projektin për menaxhimin e intergruar kufitar në Ballkanin Perëndimor dhe Tiurqinë, nën IPA më shumë programë përdoruese për vitin 2007. Gjatë vizitës së Drejtorisë Doganore u prezantuan sietemi i centralizuar kontrollues për videombikëqyrje në Drejtorinë Doganore – CCTV, sistemi për njohjen automatike të targave regjistrimi dhe vendosjen e sietmit njësportel për leje për import,eksport dhe tranzit të mallrave dhe kuota tarifore- EXIM. Në mbledhjen e “Ekipit për vlerësim dhe monitoring” me komisionin nacional për menaxhimin e integruar kufitar ku anëtar është edhe Drejtoria doganore, është theksuar se Republika e Maqedonisë është lider në vendosjen e sistemit të menaxhimit me kufinjt e integruar.
17. Më 16 tetor 2009 në Firenca është mbajtur mbledhja përfundimtare e projektit TAKTA të përkrahur nga ana e Komisionit Evropian, në të cilin si shfrytëzues të ndihmës teknike në përparimin e punës doganore kanë marrë pjesë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Serbia dhe Mali i Zi. Në shikim se një pjesë nga aktivitetet kanë rëndësi edhe për bashkëpunimin rajonal më të gjërë, përkatësisht shfrytëzimin e disa përfitimeve nga projekti të cilat janë në interes për punën doganore dhe përparimin e bashkëpunimit rajonal ndërmjet përdoruesve të ndihmës teknike në RM, në mbledhjen e Drejtorëve Gjeneral të shërbimeve doganore pjesëmarrës në projektin kanë marrë pjesë delegacion i Drejtorisë Doganore të Republikës së Maqedonisë.